



Asociacioni i Komunave të Kosovës

RAPORT

Për:	Ertan Munoglu – Menaxher i Programit
Nga:	Fisnik Dashi – Koordinator për Kolegjiume
Kopje:	Sazan Ibrahimimi – Drejtor Ekzekutiv
Data :	14 prill 2011
Subjekti:	Raport nga takimi i Kryesisë së Kolegjiumit për Administratë

HYRJE

Kryesia e Kolegjiumit për Administratë me datën 14 prill mbajti mbledhjen e rregullt të saj dhe të parën për vitin 2011.

Në këtë takim ishin prezentë z.Xhemë Binaku – Kryesues, z.Avni Nebiu – Zv.kryesues, dhe anëtarët z.Sefer Krasniqi, dhe z.Abdullah Bejtullahu. Në takim poashtu ishin prezent edhe z. Ertan Munoglu – Menaxher i Programit në AKK, dhe z. Fisnik Dashi – Koordinator i Kolegjiumeve në AKK.

Takimi kishte për qëllim fillimin e hartimit të Planit Vjetor të Punës për vitin 2011 të Kolegjiumit për Administratë dhe të përcaktoj listën e prioriteteve, objektivave, dhe aktiviteteve të Kolegjiumit, si dhe mënyrën e lobimit për përmbushjen e prioriteteve të Kolegjiumit.

PËRMBLEDHJE:

Mbledhjen e hapi z. Xhemë Binaku me diskutimin e pikave të rendit të ditës:

- Përpilimi i planit të punës së kolegjiut
- Identifikimi i nevojave për trajnim
- Vizita nëpër Komunitat e Kosovës për shkëmbim të përvojave
- Definimi i takimit të radhës së Kolegjiut
- Çështje tjera

Pas diskutimeve dhe debatit, Kryesia vendosi për këto prioritete dhe objektiva në realizimin e planit të punës të kolegjiut për administratë në vitin 2011.

- **Infrastruktura ligjore relevante për drejtoritë e administratës dhe personelit** duke pasur për objektive zbatimin e ligjit për shërbimin civil dhe ligjit për pagat, si dhe koordinimi më i mirë me ministritë e linjës.
- **Përmirësimi i shërbimeve të drejtorive të administratës dhe personelit** duke pasur për objektive përmirësimin dhe ofrimin më të mirë të shërbimeve për qytetarët.

Takimi kishte për objektive edhe përcaktimin e pikave të rendit të ditës për takimin e radhës së Kolegjiut për Administratë, ku u ra dakord që në takimin e radhës së Kolegjiut të caktohet edhe një vizitë në Komunitat e Gjilanit në zyrën pritëse/qendra për shërbime ndaj qytetarëve me qëllim shkëmbimin e përvojave të mira.

Takimi i radhës

Kryesia për fund vendosi që takimi i Kolegjiut të mbahet të martën me datën 10.05.2011 në Gjilan.

Agjenda e takimit është përcaktuar si vijon:

1. Miratimi i Rregullores së Kolegjiut
2. Plotësimi i Kryesisë së Kolegjiut (nga radhët e komunitetit serb)
3. Identifikimi i pjesëmarrësve potencial në Grupet punuese në procesin legjislativ
4. Shkëmbimi i përvojave (prezantim nga Gjilani dhe Peja, si dhe vizitë në Komunitat e Gjilanit)
5. Vlefshmëria e dokumenteve

Anëtarët ranë dakord që stafi i AKK-së të jetë përgjegjës për përgatitjen e ftesave, dhe sigurimit të ambientit ku do të mbahet mbledhja.